

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Transport i punonjësve te shoqerise ”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 79613000-4

VLERA E FONDIT LIMIT:

1'491'600 (njemilion e katerqind e nentedhete e njemije e gjashteqind) leke pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor TERMOCENTRALI-VLORE sh.a , ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar,

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, si dhe nenit.....

(shënim: plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar.

- **Argumentimi i AK :** Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Kjo vlerë është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme në funksion të realizimit me sukses të kontrates
-

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Nenin 43 **Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare** të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare _____, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të(shëno bazën ligjore), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, _____(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme. Vlera totale e kërkuar duhet të jete jo më e vogël se 20 % e vlerës së

perlllogaritur te kontrates qe prokurohet dhe qe eshte realizuar gjate tri viteve te fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
ose
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te mesiperme te kontratave te ngjashme te realizuara, e ben oferten te vlefshme

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), si dhe te nenit 43 pika1,2,3,4,6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se ata kanëpërvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Argumentimi i AK : Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën dhe per të vërtetuar aftesite tekniko-profesionale te OE me qellim permbushjen me sukses te kontrates.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2 Operatori/et ekonomik pjesmarres ne gare, per realizimin e kontrates, duhet te disponojne dokumentat e meposhtme:

1. Licence “Per kryerjen e sherbimeve te rregullta te specializuara, te transportit te udhetareve

brenda vendit”, ne perputhje me ligjin nr 8308, date 18.03.1998 “Per transportet rrugore” i ndryshuar, e vlefshme per gjithë kohën e zbatimit të kontratës.

2. Leje qarkullimi të vlefshme.

3. Certifikatën e kontrollit teknik të mjetit që do të kryejë shërbimin.

4. Patente për drejtimin e automjetit të tipit autobus.

5. Certifikatën e sigurimit të detyrueshem vjetor të automjetit.

6. Mjeti që do të kryejë shërbimin, duhet të jetë i regjistruar në QKB.

Kapaciteti i mjetit të transportit (autobus) të punonjesve, duhet të jetë jo më i vogël se 40 vende.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

- *Argumentimi:* Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41 pika 4/a, çtë VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë kapacitetet teknike dhe profesionale për ta perfunduar këtë shërbim

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike

Intinerari nga Vlora: (Shkolla e Muzikes ÷ Pergjate Bulevardit Vlore-Skele.

Ndalesat do te jene: Bulevardi Avni Rustemi - Conad- Aleksandria- Riviera) ÷Plazhi i Vjeter ÷ TEC Vlorë dhe kthim.

Distanca (Itinerari) që do të përshkohet është 8.2 km(distanca e përcaktuar nga Google Earth)
Distanca vajtje - ardhje eshte 16.4 km.

Nisja duhet te behet sipas stacioneve me rradhe si me siper te shenuara, rreth ores 7.15 min dhe punonjesit duhet te mberrijne ne Termocentralin Vlore sh.a jo me vone se ora 7 e 40 minuta, kurse kthimi nga Tec- Vlore duhet te behet pas ores 16 e 15 minuta, ore ne te cilen perfundon edhe dita e punes per punonjesit. Oraret e nisjes dhe kthimit, mund te ndryshojne ne varesi te fillimit dhe perfundimit te orarit zyrtar te punonjesve te Tec.

Kapaciteti i mjetit të transportit duhet të jetë jo më i vogël se 40 vende. Mjeti i transportit duhet të jetë në gjendje shumë të mirë teknike dhe komod për të kryer një transport sa më të sigurt.

- Kohëzgjatja e shërbimit duhet të jetë **12muaj** nga data e fillimit te zbatimit te kontrates.
- Shërbimi duhet të kryhet për çdo ditë pune përveç ditëve të Shtuna, të Diela, dhe ditëve të festive zyrtare. Mesatarisht **22** ditë pune në muaj.
- Orari i kryerjes së shërbimit sipas specifikimeve teknike me siper
- Mjeti (mjetet), qe do te kryerjne sherbimin, duhet te identifikohen me targa ne kontrate.
- Kapaciteti i mjetit të transportit duhet të jetë jo më i vogël se 40 vende.
- Mjeti i transportit duhet të jetë në gjendje shumë të mirë teknike dhe komod për të kryer një transport sa më të sigurt.

Vendi i kryerjes së shërbimit:Sipas i tinerarit te mesiperm te parashikuar ne specifikimet teknike dhe termat e references.

Argumentimi:Specifikimet teknike jane hartuar nga specialistet e fushes dhe shprehin qarte kerkesat e Autoritetit Kontraktor për cilësinë ne sherbimin e kerkuar. Ato jane hartuar ne baze te nevojave te AK per te kryer kete sherbim, duke pare largesine nga qendra e banimit si dhe vendodhjen e TEC sh.a ne nje zone relativisht te larget dhe e izoluar si dhe mos mbulimi i kesaj zone nga transporti publik.